




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



NR.01/2022

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2022 PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSISË SË TAKSËS VJETORE TË LICENCIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet lartësia e taksës vjetore dhe paraqitet metoda e kalkulimit të taksës që duhet ti paguhet Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (në tekstin e mëtuftjeshëm: “ARRU”), nga të ardhurat bruto të ofruesit të shërbimeve i cili është licencuar nga ARR.U.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Udhëzimi Administrativ përcakton termat, kushtet dhe procedurat e pagesës së taksës vjetore të licencimit për Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit, Ujërave të Ndotura dhe Furnizuesit të Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkrirjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

Neni 3
Taksa e Aplikimit për Licencë

Ofruesi i shërbimeve i paguan ARRU-së taksën e pakthyeshme të paraparë me nenin 14 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-042, në shumën prej 200.00 € (dyqind euro), për paraqitjen e aplikacionit, në ditën kur aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime i është dorëzuar ARRU-së.

Neni 4
Taksa Vjetore e Licencimit

1. Ofruesi i shërbimeve i paguan ARRU-së taksën e pakthyeshme vjetore të licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2021 në pajtim me nenin 14 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-042.
Lartësia vjetore e Taksës së licencimit është përcaktuar të jetë 1.04 % e bruto faturimit vjetor të raportuara në pasqyrat e të ardhurave të tyre për vitin 2020 të atij Ofruesi të Shërbimeve të Ujit sipas shtojcës dy (2) të këtij udhëzimi.

$$X = B \times 100/t$$

X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve

B = Shpenzimet e parapara të ARRU për vitin 2022 (shih Shtojcën 1)

t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin 2020 (shih Shtojcën 2)

2. Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve të Ujit, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit që është bashkuar (shkrirë).
3. Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe furnizuesit të ujit me shumicë, të Licencuar nga ARRU, janë të obliguar të paguajnë Taksën Vjetore të Licencimit e cila është e ndarë në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta, në çdo fillim të muajit të vitit kalendarik më së voni deri më datën pesë (5).

Neni 5
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.01/2021 për përcaktimin e lartësisë së taksës vjetore për vitin 2021.

Neni 6
Hyrja në Fuqi

Ky Udhëzim Administrative për Përcaktimin e Lartësisë së Taksës Vjetore, hyn në fuqi me 1 Janar 2022

Datë 29 / 12 / 2021
Prishtinë



Bashkangjitur në këtë udhëzim janë edhe shtojcat si në vijim:

- Shtojca 1: Shpenzimet ARRU-së sipas kufijve të fortë të buxhetit për vitin 2022*
- Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2020 të audituara dhe Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2022*

Shtojca 1: Shpenzimet Totale të ARRU- të sipas kufijve të fortë buxhetor për vitin 2022

SHPENZIMET TOTALE TË ARRU NË 2022	
1. Shpenzimet e Personelit	242,121.00
2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve	122,459.00
3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike	6,503.00
Gjithsejtë Shpenzimet e ARRU	371,083.00€

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në vitin 2020 të audituar nga ARRU, si dhe Taksa vjetore e Licencimit për vitin 2022

SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË 2020			TAKSA VJETORE PËR OFRUESIT TË SHËRBIMEVE PËR VITIN 2022		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri I Ofruesit te Shërbimeve	Regjioni	Lartësia e taksës vjetore
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "PRISHTINA" sh.a.	Prishtinë	13,932,702	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "PRISHTINA" sh.a.	Prishtinë	144,900.10
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "BIFURKACIONI" sh.a.	Ferizaj	2,144,491.00	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "BIFURKACIONI" sh.a.	Ferizaj	22,302.70
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "GJAKOVA" sh.a.	Gjakovë	4,399,372.00	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "GJAKOVA" sh.a.	Gjakovë	45,753.47
Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI" sh.a.	Prishtinë	1,293,828.00	Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtinë	13,455.81
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "MITROVICA" sh.a.	Mitrovicë	3,766,260.00	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "UJESJELLSI REGIONAL" sh.a.	Mitrovicë	39,169.11
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDRODRINI" sh.a.	Pejë	3,871,781.00	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDRODRINI" sh.a.	Pejë	40,266.52
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDROREGJIONI" sh.a.	Prizren	4,527,760.00	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDROREGJIONI" sh.a.	Prizren	47,088.70
Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDROMORAVA" sh.a.	Gjilan	2,016,101.00	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDROMORAVA" sh.a.	Gjilan	20,967.45
Totali – Ofruesit shërbimeve te Ujit		35,952,295.00€	Total taksa vjetore 2022		373,903.87